



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net



PSH. Nr. 275/22

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, pas shqyrtimit të kërkesës së ushtruar nga Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) (Protokolli 275/22), për diskualifikim të Operatorit Ekonomik (OE) "TOSI-V" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me enë, inventar" me nr. të prokurimit 632-22-4261- 1-3-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP Nr. 01/2020 (e amendamentuar) me 21 tetor 2022, mori:

V E N D I M

Aprovohet, si e bazuar kërkesa e datës 02 qershor 2022, e Komunës së Gjakovës, nga cilësia e sajë si Autoritetit Kontraktues, kurse OE "TOSI-V" SHPK. me seli në Pejë, me numër të biznesit 810749129, diskualifikohet nga aktiviteti i prokurimit numër 632-22-4261-1-3-1 dhe nga pjesëmarrja në çdo aktivitet tjetër të prokurimit, për periudhën kohore në kohëzgjatje 3 muaj, nga data 21.10.2022 gjer me datën 20.01.2023, për shkak të mospërmbylljes së detyrimeve ligjore sipas nenit 65 të Ligjit për prokurimin publik, të kërkuara në harmoni me Vendimin e AK.

A r s y e t i m

Me 02.06.2022, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së ndaj OE "TOSI V" SHPK -Pejë. Lidhur me këtë, OSHP me 06.06.2022 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për ti analizuar pretendimet e AK dhe shkresat e kësaj lënde.

Gjatë analizimit të shkresave të kësaj lënde konstatohet se, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, me 12.05.2022, ka nxjerrë Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me enë, inventar" me nr. të prokurimit: 632-22-4261- 1-3-1.

Me 23.05.2022, AK (me shënime si më sipër) ka dërguar Letrën standarde të kërkesës për sqarim, duke e kërkuar nga OE, Vërtetimin nga ATK dhe Vërtetimin nga Gjykata, me paralajmërimin se nëse dokumentet e kërkuara nuk dorëzohen brenda afatit kohor, oferta e OE-së do konsiderohet jo valide.

OE nuk i ka dorëzuar brenda afatit të caktuar dokumentet e cituara si më sipër dhe si rrjedhojë, AK ka vazhduar me tenderuesin e listuar në vend të dytë, në kuptim të kushteve të parashikuara për rrjedhur rrjedhën e aktivitetit të prokurimit, në harmoni me LPP.

Pas pranimit të kërkesës për diskualifikim të AK, OSHP i ka dërguar shkresë (e-mail) operatorit ekonomik me datën 03.06.2022, duke kërkuar që i njëjti ta informoj OSHP lidhur me të gjitha informacionet relevante me çështjen në rastin konkret. Në ndajshesë të kërkesës së cituar si më sipër, AK ka bashkëngjitur dokumentet relevante për këtë aktivitet të prokurimit, përfshirë po ashtu: Kopjen e njoftimit për kontratë dhe Kopjen e shkresë së KK Gjakovë drejtuar OE. Duke ju referuar kërkesës së cituar si më sipër të OSHP, OE "TOSI-V" SHPK. Pejë, me 06.06.2022 ka ofruar sqarimet (me e-mail) lidhur me këtë kërkesën e AK për diskualifikimin e tij. Në këtë rast, OE ka sqaruar se Drejtori i kompanisë, si i autorizuari i vetëm për tërheqjen e dokumenteve zyrtare nuk ka mundur ta tërheq Vërtetimin nga Gjykata meqë kishte udhëtuar jashtë vendit. Kurse, Administrata e kompanisë ka provuar të aplikojë në emër të kompanisë por nuk ka qenë e mundur pa autorizim nga drejtori.

Seanca e shqyrtimit kryesor u mbajt me 18 Tetor 2022 pa praninë e palëve, me ç 'rast paneli shqyrtues vlerësoj se ka prova të mjaftueshme për marrjen e një vendimi përfundimtar. Pas analizimit të gjitha shkresave të kësaj lënde, Paneli konstaton se AK ka kërkuar nga OE "TOSI V" SHPK vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, të cilat kanë qenë të domosdoshme për realizimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret. Mirëpo OE brenda afatit të parashikuar nuk i ka dorëzuar:

- Vërtetimin nga ATK se nuk ka obligime borxhe të tatimeve në ATK si dhe
- Vërtetimin e lëshuar nga një Gjykatë kompetentë se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.

Bazuar në vlerësimin e shkresave të kësaj lënde, Paneli konstatoi si në vijim:

- a) Është jo kontestuese se AK i ka kërkuara nga OE, dokumentet e cituara si më sipër, të cilat në kuptim të dosjes së tenderit janë konsideruar të domosdoshme;
- b) Është jo kontestuese se OE nuk i ka dorëzuar brenda afatit të caktuar

Për shkak të fakteve të cituara si më sipër, AK ka vazhduar me tenderuesin e listuar në vend të dytë, në kuptim të kushteve të parashikuara për rrjedhën e aktivitetit të prokurimit, në harmoni me LPP. Paneli konstatoi në vijim po ashtu se, rrjedha e veprimeve të AK ka qenë në harmoni me parimet e përgjithshme të LPP kurse, përgjigja e OE nga pikëpamja e këtij Paneli nuk përbën provë bindëse, për mospërmblidhjen e detyrimit të tij. Si rrjedhojë kërkesa e AK për diskualifikimin e OE ka bazë ligjore, sepse sipas nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit, vjen në shprehje nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokument të falsifikuar, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP, sipas të cilit, cituar: "Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare".

Paneli shqyrtues sqaron se neni 26.8 të RRUOPP parasheh se “Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B-58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se”. lidhur me nenin 65 të Ligjit për prokurimin publik (sipas DT *Aneksi 2 deklarata nën betim*), Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, dhe në bazë të nenit 99 par 2 të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se OE “TOSI-V”SHPK do të diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik në periudhë prej tre muaj nga data 21.10.2022 deri më 20. 01.2023.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Panelit e Shqyrtues
Vjosa Gradinaj-Mexhuani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Gjakovë

1x1 OE “Tosi V”SHPK

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së